



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI I KOMUNËS **KOMITETI PËR KOMUNITETE**

EKSTRAKT

nga procesverbali i mbajtur më 04 nëntor 2019, në mbledhjen e XVII-të (shtatëmbëdhjetë) të Komitetit për Komunitete, mandati VI.

Mbledhja u mbajt në sallën nr. 31 dhe filloi në orën 13:20.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi Albina Avdiu Kryesuese e Komitetit,

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e këtij Komiteti dhe atë: Valbona Kadriu-Podvorica, Benjamin Ejupi, Bashkim Sylja, Valmire Lahu, Mefail Rama, ndërsa munguan Doruntina Hasani, dhe Radisav Perović.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje të pranishëm ishin, Liman Zeqiri, shef i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, Bashkim Bajrami nga Policia Kufitare e Kosovës, Tomús Lengyel, përfaqësues i KFOR – LMT, Maja Lenher dhe Skender Shatri përfaqësues të OSBE-së

Rendi i ditës

znj. Albina Avdiu, Kryesuese e Komitetit, e hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit dhe duke i njoftuar rreth pikave të rendit të ditës, ndër të tjera shtoi, nëse ndokush dëshiron fjalën urdhëroni, nëse jo e vë në votim rendin e propozuar të ditës sipas thirrjes dhe materialit të dërguar.

Njëzëri u miratua rendi i propozuar i ditës sipas thirrjes dhe materialit përkatës të dërguar.

1. Ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 07.10.2019

Njëzëri, pa vërejtje apo plotësim ndryshime u miratua ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Komunitete e mbajtur më 07 tetor 2019.

2. Informatë nga vizita e anëtarëve të Komitetit për Komunitete në bashkëpunim me Zyrën Komunale për Komunitete dhe Kthim, KFOR-in dhe Policinë, në SHFMU Batllavë dhe Orllan si dhe në Lagjet ku banojnë familjet e Komunitetit jo shumicë.

znj.Albina Avdiu, Kryesuese e Komitetit, e paraqiti një informatë të shkurtër rreth vizitës së anëtarëve të Komitetit, shefit të ZKKK-së, KFOR-in dhe përfaqësuesit e Policisë së Kosovës, në fshatrat Batllavë dhe Orllan, ndër të tjera theksoi, gjatë kësaj vizite kemi qenë në shkollat e fshatrave të cekur. Në shkollën fillore të fshatit Batllavë vijnë mësimin 7 nxënës të Komunitetit jo shumicë, në kl. e I-rë tre nxënës, në kl. e III-të një, në kl.e VII-të një dhe në kl.VIII-të dy nxënës. Drejtori i shkollës z.Muhamet Jashari ka kërkuar ndërtimin e një trotuari në lagjen ku banojnë komuniteti jo shumicë deri tek shkolla. Gjithashtu kemi takuar përfaqësuesin e komunitetit jo shumicë z.Ragip Kovaçi nga i cili jemi njoftuar rreth gjendjes së familjeve të komunitetit jo shumicë, me theks gjendjes së banimit. I përmenduri ka thënë se gjendja në atë lagje është e mirë dhe nuk ka diçka për tu veçuar përveç punësimit dhe arsimit për të rinjtë për të cilët ka theksuar se shumica e tyre punojnë privat aq sa munden (duke veçuar sharrë druve), po ashtu ka njoftuar që nga Komuna ka pasë ndihma të ndryshme për ato familje, mirëpo ka kërkuar ndihmë në punësim ose për vazhdim të studimeve për dy vajza të cilat kanë përfunduar shkollimin e mesëm për doganiere. Po ashtu z.Përparim Kovaçi ka kërkuar mbështetje nga Komuna, qoftë lëndë djegëse qoftë pako ushqimore.

Sa i përket fshatit Orllan, jetojnë 7 familje të komunitetit jo shumicë, kryesisht gjendja e tyre është e mirë dhe nuk ka ndonjë problem. Në shkollën e fshatit po ashtu ndjekin mësimin 7 nxënës në klasë të ndryshme. Pra nuk po e zgjati më tepër, por kjo ishte një informatë e shkurtër rreth vizitës në fshatrat e cekura.

z.Liman Zeqiri, shef i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim – ZKKK, theksoi, në vija të trasha, Kryesuesja njoftoj rreth vizitës në dy fshatrat e cekura familjeve të komunitetit jo shumicë, normal që ne kemi për obligim të vizitojmë dhe të kujdesemi për familjet e komunitetit jo shumicë, të njoftohemi për së afërmi me gjendjen e tyre reale dhe faktike si dhe të marrim informata të drejtpërdrejta nga vetë ata për të gjitha preokupimet dhe sfidat e përditshme që kanë në jetën dhe shoqëri, por edhe kërkesat e tyre të ndryshme të cilat duhet t'i marrim parasysh qoftë në arsim, punësim, shëndetësi, për çështje ekonomike dhe sociale, etj.

Nëse i referohemi shkollave të Komunës së Podujevës, e them me përgjegjësi të plotë se nuk ka kurrfarë diskriminimi sa i përket nxënësve të komuniteteve jo shumicë, përveç ndonjë diskriminimi pozitiv ta quaj ashtu, që ne si Komitet për Komunitete dhe si ZKKK që mundohemi t'iu ndihmojmë atyre në fusha të ndryshme me ato mundësi që kemi, mirëpo ajo që është më qenësore për mua mund të them se kemi një barazi universale, që është e drejtë ndërkombëtare e që secili fëmijë apo secili person në Komunën e Podujevës të ndihet i lirë në jetën e tij që të punoj, veproj, mësoj, dhe gjitha sferat e jetës.

Në vizitë me ne kanë qenë edhe Policia e Kosovës dhe KFOR të cilët i falënderoj, gjithashtu ne u informuam nga drejtorët e shkollave të dy fshatrave nga të cilët u tha se gjendja është shumë e mirë dhe normale sa i përket procesit mësimor, me theks nxënësve të komunitetit jo shumicë ngase ashtu siç e kam thënë disa herë ne jemi shtet multietnik dhe i respektojmë të gjitha të drejtat universale, pa dallime të të gjitha komuniteteve jo shumicë që jetojnë në shtetin e Kosovës.

Çështja ekonomike është paksa brengosëse për të gjithë qytetarët e Kosovës, breng kjo e cila na prek edhe neve si Komunë, ku element kryesor është papunësia, por jemi optimist që punësimi i të rinjve në Kosovë do të filloj të jetë prioritet në mënyrë që rinia të mos merr rrugën për në shtete tjera. Probleme dhe vështirësi në punësim kanë edhe komunitete jo shumicë, e që nga njëherë

mund të jenë edhe kriteret ato që duhet të respektohen, fjala është tek konkurset ku nevojitet shkollimi / kualifikimi dhe procedura tjera që duhet respektuar por që në të ardhmen shkollimi i pjesëtarëve të komunitetit jo shumicë është në rritje dhe edhe kjo çështje do të rregullohet dhe do ti hapen mundësi të reja për punësim.

Gjithashtu kemi çështjen pronësore që disa herë e kemi diskutuar këtu, në këtë kontekst nëse ju kujtohet në vitet 2015-2016 ka qenë legalizimi i pronave, unë jam në dijeni se ka pasë edhe donatorë të interesuar për strehimin e disa prej familjeve të komunitetit jo shumicë me një gjendje të rëndë të banimit, por janë disa procedura administrative sipas të cilave kërkohet që prona të jetë pronë e peronit përkatës në mënyrë që t'i ndërtohet shtëpia, andaj po e ritheksoj që me legalizimin e pronave që është në proces ende, kjo do të rregullohet nga organet më të larta shtetërore sepse kjo është çështje e tyre, dhe me shpresën që do të bëhet legalizimi i atyre pronave ku ata jetojnë me vite, e që t'iu mundësoj atyre familjeve si Podujevës, si në fshatrat Batllav dhe Orllan dhe në vende tjera të mos e humbin të drejtën që në qoftë se vie ndonjë donatorë për ndërtimin e shtëpive të banimit, të kenë mundësinë për të ndërtuar, sidomos familjet e reja të komuniteteve jo shumicë sepse vërtetë kanë nevojë.

Sa i përket infrastrukturës në lagjet dhe pjesët ku jetojnë komuniteti jo shumicë, nuk kemi probleme ose telashe, vlen të ceket se në fshatin Orllan ka kërkesë për rregullimin e një rruge për të cilën si Komunë kemi dhënë premtim se do të kryhet, dhe besoj se shumë shpejt do të kryhet.

Për fund mund të themi se në të gjitha sferat e jetës, komunitete jo shumicë në Komunën e Podujevës janë të barabartë me komunitetin shumicë sepse edhe jetojmë të barabartë.

znj.Albina Avdiu, Kryesuese e Komitetit, theksoi, falënderoj parafolësin z.Liman Zeqiri për informatat dhe kontributin e dhënë për komunitetin jo shumicë në Komunën e Podujevës. Urdhëroni nëse dëshironi fjalën ndokush, nëse jo e përmbysim këtë pikë.

3. Identifikimi i personave të komuniteteve jo shumicë të cilët kanë ndërprerë procesin e mësimin shkollorë të mesëm të lartë, dhe ndërmarrja e veprimeve për përfshirjen e tyre për vitin vijues shkollor ose në procesin mësimor joformal për përfundimin e klasave përkatëse.

znj.Albina Avdiu, Kryesuese e Komitetit, theksoi, jemi në dijeni se në vitet e kaluara ka pasë nxënës të komunitetit jo shumicë të cilët kanë ndërprerë procesin e rregullt mësimor dhe të cilët kanë vazhduar me mësim jo formal (provime klasore). Për vitin e kaluar dhe këtë vit nuk e di saktë a ka pas ndonjë ndërprerje të procesit të rregullt mësimor nga nxënës të komunitetit jo shumicë, andaj nëse Shefi i ZKKK ka ndonjë informacion, lus të na jap informata.

z.Liman Zeqiri, shef i ZKKK-së, theksoi, kjo temë është paksa komplekse do thoja, madje jo vetëm tek komuniteti jo shumicë por në përgjithësi për shkak se nganjëherë për shkaqe ekonomike sociale shumë nxënës nuk mund të përfundojnë vitin shkollorë. Ne shumë herë kemi ngritur edhe çështjen e shtimit të numrit të bursave dhe disa çështjeve teknike për nxënës të Komunës së Podujevës që kanë nevoja të tilla. Sot pata takim edhe me drejtorin e Drejtorisë së Arsimit dhe me një nga zyrtarët e saj Drejtorie ku për tekste shkollorë për këtë vit ka pas një keqkuptim po e quaj kështu sepse tekstet që Komuna i siguron për nxënësit në nevojë të shkollave të mesme të larta janë sjellë në bazë të kurrikulave të vjetra apo viteve të kaluara dhe ashtu siç u njoftova sërish është bërë kërkesë që brenda javës ato tekste të sjellën ashtu siç parashihet me programin e ri shkollor. Gjithashtu kemi edhe mësimin jo formal, gjë kjo e cila është e mirë dhe në interes të shoqërisë ku për të gjitha ata nxënës apo persona të cilët për shkaqe të ndryshëm e kanë ndërprerë

shkollimin, përveç konkurseve që shpallen publikisht në vazhdimisht i njoftojmë edhe në mënyra tjera edhe pjesëtarët e komuniteteve jo shumicë, madje në të kaluarën Drejtoria e Arsimit për rastet e rënda ekonomike ka mundësuar pa pagesë vijimin e provimeve dhe pajisjen me diplomë përkatëse të gjithë. Në kuadër të kësaj ne kemi hulumtuar raste të tilla dhe për ata edhe kemi paraparë këtë pikë dhe kemi marrë detyrë që bashkërisht me Drejtorinë e Arsimit, ata persona që lajmërohen apo që identifikohen dhe që shprehin dëshirën për vijimin e provimeve në aspektin e mësimin jo formal apo t'iu mundësohet vijimi i rregullt i procesit mësimor nga aty ku kanë mbete, natyrisht duke përmbushur disa procedura dhe kritere, kjo vlen edhe për gjeneratat më në moshë për t'iu mundësuar marrjen e një diplome të shkollës së mesme sepse siç jemi në dijeni janë të nevojshme për aplikimi për punësim, pavarësisht pozitive, madje nga ajo më e thjeshta, e që ne kemi dhënë informacione të tilla dhe në një formë kemi bërë edhe presione në kuptimin pozitiv që ta shfrytëzojnë këtë mundësi, dhe viteve të fundit kemi vërejtur të gjithë se ka interesim të madh për këtë çështje që është një e mirë e përgjithshme për shoqërinë. Ne për raste të rënda kemi interferuar te Drejtoria e Arsimit, që duke prezantuar dokumentet përkatëse, persona të tillë të lirohen nga pagesa për mësim jo formal apo provime jo formale.

znj. Albina Avdiu, Kryesuese e Komitetit, theksoi, po ashtu sërish e falënderoj shefin e ZKKK-së për këto informata dhe kontributin e dhënë për komunitetin jo shumicë dhe për ofrimin e mundësive të ndryshme për arritjen e qëllimeve në aspektin e mësim nxënies dhe arsimimit të gjithë atyre të interesuarve me theks nxënësve dhe personave të komunitetit jo shumicë në Komunën e Podujevës.

4. Të Ndryshme

z. Bashkim Sylja, paraqiti nevojën e ngritjes së një grupi punues për përgatitjen e planit të punës së komitetit për Komunitete për vitin 2020.

Pas diskutimeve mes anëtarëve të Komitetit, si përfundim mbetet që në mbledhjen e radhës të ngritet një grup punues për përgatitjen e planit të punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2020, si dhe përgatitjen e një informate rreth punëve dhe aktiviteteve të Komitetit për Komunitete gjatë vitit 2019

Meqë nuk pati diskutime tjera, Kryesuesja e Komitetit e konstaton të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në orën 13:45

Procesverbalin e mbajti
Enis Sheholli

Nr. 01-060/04-0085764/19
Podujevë,
04 nëntor 2019

Kryesuese e Komitetit
Albina Avdiu
